

Prishtinë, 09 qershor 2006

## KOMUNIKATË PËR SHTYP

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (“ZRRE”) njofton se në përputhje me Nenin 10 të Ligjit 2004/09 mbi Rregullatorin e Energjisë, i ka dorëzuar Parlamentit dhe PSSP-së, **Raportin Vjetor dhe Gjendjen Financiare për vitin 2005**. Ky është raporti i dytë vjetor i nxjerrë nga ZRRE-ja dhe duke qenë një dokument që përmban informata me vlerë për zhvillimet në sektorin e energjisë, kornizën rregullative dhe mundësitë për investime në Kosovë, ky dokument i është dërguar gjithashtu shumë palëve të interesuara dhe investitorëve rajonalë dhe ndërkombëtarë të përfshirë në sektorin e energjisë.

Në përputhje me Nenin 11.2 të Kornizës Kushtetuese të Kosovës, ZRRE-ja është një autoritet i pavarur publik dhe ka mandat për rregullimin ekonomik të të gjitha aktiviteteve të sektorit të energjisë në Kosovë (energjisë elektrike, ngrohjes qendrore dhe gazit natyror). ZRRE-ja gjatë vitit 2005-2006 ka përfunduar procesin e rekrutimit të stafit (25) dhe ka punuar në ngritjen e kapacitetit përmes trajnimeve dhe ndihmës teknike nga konsulentët ndërkombëtarë.

Gjatë po kësaj periudhe raportuese, ZRRE-ja ka vazhduar të zhvillojë kornizën rregullative të energjisë në Kosovë duke miratuar (pas procedurave gjithëpërfshirëse dhe rigorozë të Konsultimeve Publike) “Metodologjinë e Tarifave”, “Statutin e ZRRE-së”, “Kodin e Sjelljes dhe Etikës”, “Rregullin mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve”, “Rregullin mbi Licencimin”, “Rregullin mbi Shkycjen”, dhe “Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji”, ndërsa disa rregulla të tjera duke përfshirë “Rregullin mbi Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja të Gjenerimit” dhe “Rregullat e Tregut” janë ende në proces të konsultimit publik dhe pritet të miratohen së shpejti.

Sa i përket pjesës tjetër të vitit 2006, ZRRE-ja është duke punuar në **Shqyrtimin e Parë të çmimeve për sektorin e energjisë elektrike**, i cili në fund të vitit, do të përfundojë me tarifën e re të ndarë dhe atë të shitjes me pakicë duke përfshirë elementin social për konsumatorët e varfër të sektorit të energjisë elektrike në Kosovë, si dhe ka filluar për të tretën herë procedurën e shqyrtimit të **çmimit ngrohjes qendrore** për sezonin e ngrohjes qendrore 2006-07 dhe do të japë **licenca** për të gjitha ndërmarrjet e energjisë duke përfshirë importet/eksportet ndërkombëtare.

Raporti Vjetor i ZRRE-së është dokument publik dhe mund të merret në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së: [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)